



K.DH.SH.II.nr.1006/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Bibaj” AE Sh.p.k me seli në Fshati Livagj-Graçanicë të cilën sipas autorizimit e përfaqëson SCRL Partners SH.A. me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.483/19, të datës 02.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.10.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “Bibaj” AE Sh.P.K me seli në Fshatin Livagj - Graçanicë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.483/19, të datës 02.09.2021, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar në dispozitivin e I ka Aprovuar pjesërisht padinë e paditësit “Bibaj” AE- Sh.P.K me seli Fshati Livagj – Graçanicë sa i përket rivlerësimit të mallit për DUD-at kontestues nr.30210 të datës 18.12.2018 dhe DUD R-30889 datë 25.12.2018 të ZBD Ferizaj si e bazuar. Në dispozitivin e II është Anuluar pjesërisht Aktvendimi nr.01.3.2.2/744,795,756 të datës 15.01.2019 i Doganës së Kosovës në pjesën e vendimit sa i përket rivlerësimit të mallit për DUD-at kontestues nr. 30210 të datës 18.12.2018 dhe DUD R-30889 datë

25.12.2018 të ZBD Ferizaj, dhe lënda i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Në dispozitivin e III është refuzuar kërkesëpadia e paditësit “Bibaj” AE- Sh.P.K me seli Fshati Livagj – Graçanicë, në pjesën e vendimit nr. 01.3.2.2/744,795,756 të datës 15.01.2019 sa i përket rivlerësimit të mallit për DUD-at kontestues nr.27675 datë 21.11.2018, R-28625 datë 01.12.2018, R-28571 datë 01.12.2018, si dhe DUD R-26879 datë 13.11.2018 si e pa bazuar. Në dispozitivin e IV Mbetet në fuqi pjesërisht aktvendimi nr. 01.3.2.2/744,795,756 të datës 15.01.2019 në pjesën e vendimit kontestues sa i përket rivlerësimit të mallit për DUD-at kontestues nr.27675 datë 21.11.2018, R-28625 datë 01.12.2018, R-28571 datë 01.12.2018, si dhe DUD R-26879 datë 13.11.2018.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit e ushtruar ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative A.nr.483/19 datë 02.09.2021 dhe të Anullohet si i pa bazuar në tërësi Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 483/19 datë 02.09.2021 sipas të cilit Aktgjykim është aprovuar pjesërisht si e bazuar padia e paditësit dhe është refuzuar kërkesëpadia e paditës për sa i përket pjesës së Aktvendimit 01.3.2.2/744,795,756 datë 15.01.2019 në pjesën e DUD-ave R-27675/21.11.2018, R-28625/01.12.2018, R-28571/01.12.2018 dhe R-26879/13.11.2018 dhe është lënë në fuqi pjesërisht aktvendimi i organit të paditur Dogana e Kosovës.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63.2 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr.01.3.2.2/744, 795, 756 të datës 15.01.2019 ka refuzuar kërkesat e subjektit në procedurë “Bibaj” AE- Sh.P.K – Graçanicë për

rishqyrtimin e vendimit nr. R-27675 datë 21.11.2018, R-28625 datë 01.12.2018, R-28571 datë 01.12.2018, R-26879 datë 13.11.2018, R-30210 të datës 18.12.2018 dhe DUD R-30889 datë 25.12.2018 të ZBD Ferizaj si të pa bazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ-Divizion Fiskal për këtë çështje ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor me datë 02.09.2021 në prani të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur dhe vërtetimit të gjendjes faktike, merr aktgjykimin e ankimuar, sipas dispozitivit, me arsyetim se vendimi kontestues për DUD-at nr.30210 të datës 18.1.2018 dhe DUD R-30899 datë 25.12.2018, nuk përmban informata të mjaftueshme me të cilën pala e paditur do të mund të kundërshtonte vlerën e paguar përmes faturës, pasi që paditësi deklaratave doganore kontestuese ia ka bashkangjitur faturën, transaksionin bankar për pagesën e faturës dhe dokumentet përcjellëse me të cilin e ka paguar mallin lëndor për DUD-at nr.30210 të datës 18.12.2018 dhe DUD r-30889 datë 25.12.2018 të ZBD Ferizaj e të cilat pretendime i ka konstatuar edhe ekspertit financiar në ekspertizën financiare. Vendimi i kontestuar për rivlerësimin e mallit lëndor për DUD-at nr.30210 të datës 18.12.2018 dhe DUD R-30889 datë 25.12.2018 nuk përmban një vlerësim të fakteve në raport me dispozitat ligjore andaj një vendim i tillë nuk mund të quhet se është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se është marr me respektimin e dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën Administrative. Bazuar në nenin 81.F par.2 të Ligjit nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222 se *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*. Gjykata e obligon të paditurën se në rishqyrtim dhe rivendosje për DUD-at kontestues nr.30210 të datës 18.12.2018 dhe DUD R-30889 datë 25.12.2018 të deklarohe lidhur me provat e administruara lidhur me faturat dhe transaksionin bankar të mallit lëndor si dhe të vlerësoj edhe ekspertizën financiare të ekspertit financiar dhe si rrjedhojë pas konstatimit të kësaj gjendje faktike të marr vendim të drejtë dhe të bazuar në dispozitat ligjore të KDA-së dhe nëse konstatohen pretendimet e tilla e paditura ne rivendosje duhet t’ia pranoj paditësit deklarinimin e vlerës reale të mallit në bazë të faturës dhe t’ia kthej mjetet e paguara me tepër ne emër të taksave doganore.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë. Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i kësaj gjykate, vlerëson se

aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje sipas pretendimeve ankimore, as me shkelje qenësore të dispozitave të LKA-së, dhe të LPK-së, të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar-aktvendimit të Doganës së Kosovës, të ankimuar nga paditësi si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, me të cilin aktvendim në procedurë administrative e gjithashtu edhe në procedurë gjyqësore sipas aktgjykimit të ankimuar me ankesë, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se paditësi nuk ka prezantuar dokumentacion të harmonizuar dhe të kompletuar për të dëshmuar se çmimi i deklaruar është çmimi real i paguar për mallin lëndor kontestues për DUD-at kontestues nr. R-27675 datë 21.11.2018, R-28625 datë 01.12.2018, R-28571 datë 01.12.2018, R-26879 datë 13.11.2018, ku gjykata ka shqyrtuar dokumentacionin përcjellës të mallit lëndor përkatësisht transaksionin bankar për të cilën pretendon paditësi se është bërë pagesa e mallit lëndor të deklaruar për DUD R-26879 pasi që në bazë të konstatimeve dhe ekzaminimit të dokumentacionit i cili gjendet në shkresat të lëndës nga eksperti financiar është konstatuar se transferi bankar i datës 14.11.2018 në vlerë prej 150,000.00€ pas mbledhjes dhe kalkulimit ka ardhur në përfundim se ekziston një diferencë prej 14,157.62€ ma e madhe në fatura se sa në transferimin e mjeteve monetare, andaj në bazë të përlllogaritjeve se shuma e faturave që janë përshkruar në transferim nuk përputhet me shumën e transferuar. Ndërsa lidhur me DUD-at kontestues nr. R-27675 datë 21.11.2018, R-28625 datë 01.12.2018, R-28571 datë 01.12.2018 paditësi nuk ka paraqitë provë të mjaftueshme dhe të harmonizuar për mënyrën e pagesës për mallin lëndor, e që nga gjykata është shqyrtuar dokumenti i quajtur urdhërpagese e datës 24.12.2019 për të cilin paditësi ka deklaruar se ka paguar me kesh për shkak të pamundësisë së kryerjes përmes transferit ndërkombëtar dhe kjo pagesë është bërë më vonë për shkak të barazimeve e cila provë edhe sipas ekspertit përfshihet për këta 3 DUD-at e lartcekur. Kolegji i kësaj gjykate njëjtë si gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se kjo pagesë me kesh është bërë një vit pas importimit të mallit lëndor edhe pasi është nxjerr aktvendimi kontestues, mirëpo sipas pikës 7 të marrëveshjes për vitin 2018 e cila gjendet në shkresat e lëndës lidhur në mes të shitësit dhe blerësit – importuesit në pikën 7 të kësaj kontrate *“afatet e pagesës”*, parashihet se *“pagesa nga distributori bëhet përpara dërgesës së prodhimeve të kontratës”* ndërsa në asnjë pikë të kësaj marrëveshje nuk parashihet se paditësi mund të bëjë

pagesën për mallin lëndor të paraqitur për zhdoganim për DUD-at kontestues të lartcekur, edhe pas kësaj periudhe ku është paraqitë ky dokument i datës 24.12.2019. Andaj nga e gjithë kjo situatë edhe Kolegji i kësaj gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës ka aplikuar nenin 35 të KDA-së i cili parasheh zbatimin e metodës së gjashtë të vlerësimit *“Kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 33 ose 34 do të përcaktohet në bazën e të dhënave të disponueshme në Kosovë, duke përdorë metoda të arsyeshme në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme”*, andaj mbi këtë bazë e paditura ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore të lartcekura të KDA-së kur e ka ngritur bazën doganore për mallin që është objekt lëndor i këtij konflikti administrativ. Prandaj edhe pretendimet e paditësit, as Kolegji i kësaj gjykate nuk i ka pranuar si të bazuara për arsye se paditësi është dashur që të provoj saktë me prova materiale argumentet dhe pretendimet e tij në padi dhe ankesë pasi që paditësi në rastin konkret bartë detyrimin e vërtetimit të pretendimeve në padi ndërsa provat e paraqitura në Gjykatë nuk janë me ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e Arovimit pjesërisht dhe kthimit të lëndës në rishqyrtim dhe rivendosje të një pjese të aktvendimit për rivlerësimin e mallit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1006/22, me datë 12.10.2023

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri